

TE POEZIA KAM GJETUR NDIHMË

Intervistë me Gjekë Marinaj, botuar në "Bota Sot"

-- nga **Shefqet Dibrani**, dhjetor 2003



Bota Sot: *Z. Marinaj, libri juaj më i ri "Ana tjetër e pasqyrës", botuar në Dallas të Amerikës, sapo ka dalë nga shtypi. Si ju ka lindur ideja për një libër bisedash të tilla, dhe a mendoni se ia keni arritur qëllimit?*

Gj. Marinaj: Ideja për ta botuar librin në fjalë më është shfaqur relativisht vonë. Unë gjithnjë argëtoj mendimin se formula më e domosdoshme për rritjen e diapazonit kulturor të njeriut është edukimi i pandalshëm në sa më shumë fusha të jetës, që të jetë e mundur. Duke qenë i ndërgjegjshëm se koha dhe njeriu kanë punuar vazhdimisht për ne, mbetem një mirënjohës i madh për mësimet që kam nxjerrë nga magjia e mendjeve dhe e veprave më të ndritura shqiptare dhe botërore. Gjithmonë më kanë pëlqyer reagimet, kërkimet dhe eksperimentet si me të bukurën, ashtu edhe me të panjohurën. Shtresat e niveleve për përfundimin e këtij libri me intervista kanë

qenë krejt të ndryshme nga ato të publicistikës tradicionale. Në fillim, nuk kam punuar fare me shqetësimin se patjetër duhej konsideruar potenciali universal i të intervistuarve. Sidomos në intervistat e para, as që e kam pasur publikun në mendje. Vetëm më vonë, kur botimi i një përmbledhjeje si kjo m'u shfaq si ide, kam filluar të debatoja me veten për strategjinë e punës. Deri në atë kohë, pyetjet i bëja me sinqeritet, që dy të panjohur i bëjnë njëri-tjetrit gjatë një udhëtimi të përbashkët me tren ose avion. Të intervistuarit i pyesja vetëm rreth atyre pikave, që seriozisht dëshiroja të dija diçka rreth tyre. Ky joformalitet ka ndikuar që intervistat të dalin disi "eksentrike" si në seleksionimin e të intervistuarve, ashtu edhe në natyrën e pyetjeve që u kam drejtuar personaliteteve në fjalë. Më vonë, natyrisht, mirënjohja dhe respekti im ndaj lexuesit dhe të intervistuarve, ka fituar gradualisht gravitetin profesional, që kërkon gazetaria e vërtetë. Për sa i përket arritjes së qëllimit, për hatër të Hemingueit, i cili thoshte: "Sa më të mirë të jenë shkrimtarët, aq më pak flasin për veprat e tyre", gjykimin po ia lë lexuesit.



Bota Sot: *Ju keni fituar emër si dashurues i jorëndomtë i poezisë. Sa e vështirë ka qenë për ju të merrni kohë nga poezia për t'ia dedikuar atë një libri me prozë publicistike, pra me intervista?*

Gj. Marinaj: Po. Mua poezia ma ka dhënë atë botë, që Zoti u ka dhënë njerëzve që i besojnë pa kushte Atij. Poezia ma ka drejtuar shpirtin drejt përsosjes, më ka dhënë shpresë, ma ka dhënë besimin se çdo sakrificë për të është më se e vlershme, më ka bindur se ajo është një ndër rrugët më të sigurta drejt parajsës së artit - vendit, ku poetët e vërtetë shpresojnë ta gjejnë pavdekësinë. Te poezia kam gjetur ndihmë kur kam qenë i uritur, kur kam ndjerë vobekje, tek jetoja faktin kur unë, familja ime dhe i gjithë populli i ndershëm shqiptar po shkrihej në metrolugjinë e kuqe komuniste. Poezia ime më bëri të largohem nga Shqipëria, prej së cilës, kur u nisa, mora vetëm ca fotografi të familjes, pesë libra me poezi nga autorët tanë dhe një mal me mall të papërshkrueshëm.

Nuk ka ndonjë ndryshim të madh mes poezisë dhe poetëve, në krahasim me shpirtin e atyre njerëzve zemërbardhë, që shpesh me vetëdije e lënë veten keq për t'i ndihmuar të tjerët. I vetmi ndryshim është se poezia dhe poetët janë edhe më të këtillë. Do të ishte mirë, pa dyshim, që poetët t'ia dedikonin të gjitha energjitë, gjithë pasionin dhe gjithë kohën e mundëshme poezisë dhe vetëm poezisë. Zbatimi i një praktike të tillë do t'i jepte letërsisë sonë një potencial poetik shumë më të fuqishëm nga kjo që gëzon sot. Por, kjo gjë, të paktën për mua, ka qenë dhe është e pamundur, sepse edhe shpirti i poetit i ka efektet e tij anësore; ai do që të shpërthejë në drejtime të reja, të ndërmarre aksione të natyrës aventuriere e të komunikojë me gjithësinë në gjuhën superiore të artit. Shpirti i poetit nuk mund të konsiderohet kurrë një ushtar i bindur i arsyes së poetit që, idealisht, do të duhej ta komandonte deri diku atë. Ai është tepër i brishtë një moment dhe po aq i furishën momentin tjetër. Një çast ëndërron t'i veshë malet e zbardhura nga dëborat me blerim e lule dhe çastin tjetër do t'i çajë në mes me një "grusht të fortë". Kjo ndodh sepse poeti jeton më afër se kushdo tjetër me fatet dhe fatalitetet e njeriut. Njeriu është eprori më i pranueshëm i shpirtit të poetit. A

ndjehem fajtor që poezisë së mirëfilltë i kam hyrë kështu në hak?, do të pyesnit ju. Jo, vertët jo! Unë kam intervistuar personalitete të jashtëzakonshme për lexuesit e sofistikuar dhe ata mesatarë njëherësh. Pra, me fjalë të tjera, unë kam biseduar me njerëz për njerëzit, që do të thotë se një punë e tillë e ka poezinë brenda vetes.

Bota Sot: *Librat me intervista shpesh vuajnë nga një konotacion vetëlavdërimi që u jepet të intervistuarve. Në librin tuaj, ama, ju keni mundur t'i shmangeni këtij evenimenti. Si e keni arritur këtë?*

Gj. Marinaj: Është e vërtetë ajo që thoni. Kjo zakonisht ndodh me njerëz të kalibrit të vogël nga pikëpamja intelektuale. Shmangia e lëvdatave ka meritën e saj në këtë libër, por jo meritën time. Ajo u takon të 31 të intervistuarve, të cilët u treguan aq seriozë në përgjigjet e tyre. Në të vërtetë, problemi i vetëlavdërimit i kalon caqet e intervistave publicistike. Sidomos këtë dekadën e fundit kam vënë re se disa njerëz, në vend se të dëgjojnë, orvaten të thonë diçka dhe në vend që të lexojnë diçka, lëshohen të shkruajnë... Kjo është si të përpiqesh ta ndërtosh katin e dytë të një pallati para se të kesh ndërtuar katin e parë të tij. Ndoshta pikërisht në qendër të këtij rrethi problematiko-shoqëror mund të kërkojen arsye që sot gojëtarisë, si një barametër që dikur peshonte civilizimin e njeriut, i ka rënë disi vlera. Për mua, sidoqoftë, arti oratorik mbetet i një rëndësie të lartë. Eksplorimi i mendimeve të mëdha dhe shprehja e tyre në mënyrë spontane, janë dhe do të mbeten cilësi esenciale të njeriut intelektual. Shumë prej të intervistuarve që kam përmbledhur në librin "Ana tjetër e pasqyrës" kam parë se gëzojnë aftësi të jashtëzakonshme të mendimit kritik. Ajo që më ka çuditur edhe më shumë është se ata, në mënyrë krejt natyrale, krijojnë metafora të skalitura me mjeshtëri dhe i përdorin ato si elemente ilustruese në të mirë të argumenteve që ata jepnin në lidhje me pyetjet që u bëja.

Bota Sot: *Në librin tuaj gjendet një përbërje e pasur personalitetesh nga profesione të ndryshme, dhe kjo mund të themi se ia ka dhënë atij destinacionin e dëshiruar! Në mos është pikërisht arritja e destinacionit të dëshiruar ajo që "fshihet" pas titullit "Ana tjetër e pasqyrës"?*

Gj. Marinaj: Në titullin e librit, natyrisht, pasqyra ka një definitet të përafërt, por më të komplikuar se një sipërfaqe e rrafshët që zotëron mundësinë për të formuar një imazh virtual të objektit që gjendet para saj. Aty kemi të bëjmë më tepër me një përbërje humane që me besnikëri reflekton ose jep ngjyrat dhe vlerat e vërteta të njerëzve tanë. Këta të 31 të intervistuar janë mostër e substancës që përbën anën tjetër të kësaj pasqyre. Ne shkojmë pranë rezultateve të punës së tyre për ta parë veten, me shpresë se do të jemi të kënaqur me imazhin e vetes që shohim aty. Mirëpo, nganjëherë e harrojmë faktin se sado të bukur (në kuptimin estetik) ose të mirë (në kuptimin etik), sado të pasur (në kuptimin ekonomik), sado të demokratizuar (në kuptimin politik) të jemi, po të jetë e turbullt, e qorruar, ose e tymosur ana tjetër e pasqyrës, reflektimi i vetes do të na linte për të dëshiruar.

Bota Sot: *Libri në fjalë është një e re në librat me intervista në letërsinë shqipe. Sa e vështirë është të shkruash një libër të këtillë, apo më mirë të themi sa e vështirë ka qenë për ju realizimi i këtij projekti gazetar?*

Gj. Marinaj: Ju e thatë saktë. Librat me intervista janë krejt të rrallë në letërsinë shqipe. Unë mund të them që në mëngjes, kur gazetarëve u ndahen detyrat, intervistat janë gjëja e fundit që ata dëshirojnë t'u ngarkohet si detyrë e ditës. Intervistat sjellin vështirësi nga më të ndryshmet në punën e gazetarit. Së pari, personalitetet e mëdha kanë rrjetin e tyre publicistik. Sa më i famshëm të jetë njeriu që ke interes ta intervistosh, aq më e madhe është vështirësia për t'u takuar dhe biseduar me të. Së dyti, kur i drejton mikrofonin tjetrit, do të thotë që mbi 90 për qind e punës është e përfunduar, sepse është detyra e gazetarit që ta njohë dhe ta studiojë mirë të intervistuarin nga më shumë se një anë, për

të genë i gatshëm për bisedën. Pika e tretë e procesit të intervistimit ka të bëjë direkt me aspektin e aftësive profesionale të gazetarit për ta bërë të intervistuarin partner në bisedë. Është fjala për fshirjen e asaj vijës së padukshme që ndan të intervistuarin nga intervistuesi. Gazetari me përvojë e ndjen mirë kur e arrin një gjë të tillë, sepse ajo përbën ndër bukuritë më absolute në punën e tij. Këto janë disa prej vështirësive që edhe unë, si të gjithë gazetarët e tjerë në punën e tyre, kam pasur gjatë ndërtimit të këtij libri. Megjithatë, kjo nuk do të thotë se të ashtuquajturat “gjëra të vogla” të gazetarisë nuk kanë shtuar presion profesional në punën time. Natyrisht, respekti i madh që gëzoj për ata që kam arritur t’i intervistoj, më ka ndihmuar që t’i bëj ata të duken sa më mirë në paraqitjen e tyre. Aplikimi i metodave që kam ndjekur ka qenë mjaft efektiv në punën time. Ndër të tjera, mund të them se jam munduar me gjithë shpirt, që mirësia që do të sillte intervista të jetë sa produkt i pyetjeve të mia, aq edhe produkt i përgjigjeve të të intervistuarve. Këtë e kam kërkuar te puna ime, sidomos në kriteret e arsytimit analogjik që duhet bërë rreth pyetjeve, si dhe te thellësia që kam tentuar, përkundrejt labirinteve të çështjeve sensitive e personale të intervistuarve, sepse dihet që e vërteta në gazetari nuk është gjithmonë objektive. Për individin, e vërtetë është vetem ajo që beson ai ose ajo. Vëçanërisht për problemet personale, sociale dhe politike, përkufizimi i së vërtetës mund të jetë i ndryshëm për këdo. Por, pikën kulmore të vështirësive që kam pasur në punën me këtë libër e ka prekur seleksionimi i intervistave. Për ta respektuar lexuesin dhe kërkesat e mia profesionale, më është dashur të botoj vetën 31 intervista nga 73 të intervistuar. Ky ka qenë një konkluzion mjaft i vështirë për mua.

një populli për të administruar vetveten përmes politikës, faktorët që çojnë në mbijetesën e një kombi, hapësirat, kuptueshmërinë, si dhe mirëqënien shoqërore në përgjithësi, që jep një regjim i lirë e demokratik, përkundër regjimeve totalitare.

Intervistat letrare, Marinaj i fillon me poetin tonë të shquar Dritëro Agolli, të cilin siç shihet e ka për zemër. Marinaj e përdor poezinë jo vetëm si art i të shprehurit të saj në një mënyrë sa më konçize të ndjenjës, mendimit filozofik apo forcës emocionale, por edhe si ushqip shpirtëror, të cilës i referohet herë-pas-herë, ku merr edhe pjalmin e bukur të ngjizjes së ideve të reja. Ai i referohet vargjeve të Agollit "Kur të jesh mërziur shumë/ në raft të librave kërkomë..." etj. etj. që tregon edhe forcën shlodhëse të një poezie të bukur dhe përjetësinë e saj në melodinë e brendëshme të njeriut. Pason më pas intervistat me shkrimtarë dhe poetë si Ismail Kadare, Naum Prifti, Agim Shehu, Anton Çefa, Shefqet Dibrani, Skifter Këlliçi, etj. të cilët së bashku me autorë të tjerë të talentuar, i japin librit një përqindje të lartë vlerash artistike, ku flitet padyshim edhe për vështirësitë e krijuesve shqiptarë nën kazmën e rëndë të realizmit socialist.

Marinaj i ka kushtuar një vëmendje të veçantë në libër atdhetarit të madh dhe me famë nga Malësia e Madhe, Prenkë Gruda, autor i librit "Ditari i një zemre të lëndueme", të cilin e ka vizituar në shtëpinë e tij në Florida, vetëm pak muaj para se ai të mbyllte sytë në lumnimin e tij të përjetshëm. Ndonëse i lodhur nga sëmundja e rëndë, Prenka i hipën makinës së tij dhe niset për në bregdet, bashkë me autorin e librit në fjalë: "Shikoje detin! Nuk është i turbullt se është i thellë - i thotë ai Gjekës - Cektësia i turbullon gjërat. Matu me detin kur shkruan... duaje njeriun dhe Shqipërinë sa do ky det bregun! Ky është peshqeshi im, që kam për ty." Pa këto fjalë filozofike të një atdhedashurie të nevojshme për ne shqiptarët në këto kohë, libri mund të kishte qenë më i mangët. Në fakt, libri me intervista i Gjekë Marinajt përshkruhet gjatë gjithë kohës nga një fill i hollë i një atdhedashurie të kuptueshme.

Marinaj prodhon art duke ndërthurur karaktere të ndryshme, që i përkasin fushave dhe pasioneve të ndryshme. Kot nuk pyesin "Ku e ke shtëpinë?", "Tek fshati i gruas..." është përgjigjia. Edhe Marinaj në këtë rast nuk i ka shpëtuar ketij orientimi instiktiv, kësaj përkujdesjeje xhentile, që ai tregon për gjysmen e bukur të tij, bashkëshorten romune. Dusita Marinaj, së cilës autori ia përkushton librin me shumë dashuri, ka në familjen e saj të afërt një futbollist romun me famë, Millodrag Bellodediç, me të cilin fillohen edhe intervistat me personalitetet e sportit shqiptar dhe botëror. Kemi këtu një larmishmëri personalitetesh sportive, duke përfshirë futbollistin tironas Sulejman Demollari, apo intervistën me yllin e futbollit botëror Pele, për ta mbyllur me legjendën e futbollit kosovar Fadil Vokrrin.

Duket qartë se idenë për të bërë një libër të tillë, Marinaj e ka bluar me kohë. "Ana tjetër e pasqyrës", që ka dalë në qarkullim para pak kohësh nga shtëpia botuese Marinaj Publishing në Dallas, është shpërndarë tashmë në libraritë dhe bibliotekat shqiptare, ashtu edhe në disa vende të ndryshme të botës. Në Shqipëri dhe Kosovë libri ka një çmim simbolik, në krahasim me çmimin e tij real të botimit cilësor dhe çmimin e shitjes jashtë shteti, të cilin po ia lëmë lexuesit ta zbulojë vetë.

Pas titullit të librit dhe hyrjes së shkruar nga autori, intervistat shoqërohen me një sqarim të shkurtër hyrës, ku lexuesi njihet shkurtimisht me të intervistuarin, i cili më pas bëhet më i dukshëm përmes intervistës së drejtëpërdrejtë. "Ana tjetër e pasqyrës" simbolizon pjesën e padukshme të një karakteri, çfarë fshihet pas një personaliteti me famë, pas një krijuesi të talentuar, apo pas një njeriu të njohur nga të gjithë? Këtij trilli interesant e kurioz njëherësh, Gjekë Marinaj ka provuar

t'i japë përgjigje, përmes pyetjeve të tij dhe fjalëve të të intervistuarve.
Me pak fjalë: një libër që ia vlen të lexohet!

TEOREMA E JETËS NË PAFUNDËSI



- nga **Prend BUZHALA**, Botuar në gazetën "Rilindja"



Gjekë Marinaj deri më tash ka botuar dy libra me poezi: "Mos më ik larg" (1995) dhe "Infinit" (2000). I përfshirë në valën e fatit kolektiv të hemorragjisë së largimeve nga Atdheu, Gjekë Marinaj do ta ketë ndjerë tensionin e fortë shpirtëror e dramatik të përmallimit për Shqipërinë.

Kjo etikë e kjo kulturë përmallimi do të kenë nevojë për shtrirje përjetimi e ndjeshmërie në hapësira të tjera: në hapësirat e botës shqiptare, në Kosovë, në hapësirat planetare dhe në

hapësirat ekzistenciale. Këto hapësira t'i sugjeron edhe titulli i librit, kurse medium për t'i shpërfaqur ato para botës, është vetë arti poetik, i ndërlidhur fort me kontekstet e hapësirave të përmendura.

Marinaj nuk do të bëjë pjesë në radhën e poetëve që i "zhgënjen" koha e sotme pas idealeve "të përmbysura" për një shoqëri të "drejtë"; ai nuk bën pjesë as në mesin e "të zhgënjyerve" për përmbysjet e së djeshmes. Ai do t'i shquajë, megjithatë, tonin dramatik të ekzistimit e të dhembjes, por edhe tonin përplot vrujime të përsiatjeve e të gërmimeve lirike refleksive në socialen, në realitetin social. Vetë socialja, siç do të thoshin dijetarët e moçëm antikë, Platoni e Aristoteli, përbën thelbin e letërsisë, sepse letërsia përfshin mbrenda veprës një botë shoqërore, një botë të vlerave e të shprehive gjuhësore-ligjërimore, sikundër nënvizojnë mendimtarët e mëvonshëm.

Nënshtetësia e dashurisë: atdheu i bukurisë

Cili është boshti i këtij universi e i kësaj pafundësie lirike-meditative? Universin e tij poetik, si dhe pafundësinë me minuset e pluset e saj, Gjekë Marinaj e nis me shtysën më të fortë tematike e ideore, që i jep kuptim jetës, siç është dashuria. Cikli i poezive "Cili nga ne jam unë", përbëhet nga lirikate e dashurisë. Kjo tërësi poetike-tematike është vënë me dashje në ballë të librit dhe jo rastësisht e përbën ciklin më të plotë. Kurse universi i pakufishëm i dashurisë e përbën preludin poetik të këtij infiniti, për të vënë ekuilibër jetësor, ekuilibër drejtësie e ekuilibër social e deri edhe ekuilibër planetar, tek këndon për vajzat e Kalifornisë, të cilat:

*Ecim majë gishtave mbi krahët muskulozë të tokës
duke endur çudira në lëvizjen e hijeve (...)
heshtin në gjuhë tamlore
zëri u zgjatet si një ushtimë në të ardhur...*

Te "Fytyra e dashurisë" ai do të gërmojë në pafundësinë e bukurisë, në çudirat e një ëndrre erotike e në enigmat e saj. Prandaj, ai e shpall se nënshtetësia e krijuesit është Atdheu i bukurisë (poezia "Shoqet e zyrës sime"). Folësi lirik, fluksin e imazheve e të ndjesive, do ta përndezë në identifikimin e së bukur; s me detin, si dhe në identifikimin e jetës me artin:

*E bukura e detit e la mënjanë detin për mua?
Deti qan,
Mbildhet, hapet e përplaset plot zhurmë...*

Përkthyesat që pritet ta dinë detishten, heshtin

(poezia "Gusht, diku në ishujt e Meksisë")

Për ta përkufizuar jo vetëm admirimin ndaj dashurisë, po edhe kompleksitetin stilistik të saj në poezi, poeti e ka krijuar, pra, me aq mjeshtri një fjalë-figurë të tillë (detishtja, deti/dashuria). Do të identifikohet Dashuria me Njeriun: dashuria është arsye e ekzistencës, kurse njeriu është "universalizmi tek e njënjëshmja", thuhet dikund. Identifikimi i dashurisë me Bukurinë dhe me thellësinë, me pafundësinë, shfaqet edhe njëherë te poezia "Sepse një ditë të pashë me detin", ndërsa në poezinë "Minuti im i ngathët", krijuesi e realizon artistikisht një sintaksë eliptike, për ta dramatizuar e për ta tensionuar sa më shumë refleksionin poetik.

Denoncimi poetik i padrejtësisë

Ashpërsinë e një etike të fortë, burrërore, pra të qëndrimit njeri para njeriut, Gjekë Marinaj do ta këndojë në ciklin e dytë të poezive "Kur poeti dëshiron të mos jetë poet". Notën sublime të kësaj etike do ta gërmojë tek e bukura, tek estetikja, apo tek krijuesit siç janë Van Gogu, Azem Shkreli apo Prenk Gruda. Sado që do të futet në analogjitë konceptuale të metafizikës, ky krijues do ta kërkojë jetën gjithnjë në lëvizje, do ta gjurmojë atë ndjenjë dashurie gjithnjë të natyrshme, do të shtrojë probleme gjithnjë të larmishme, ashtu siç është vetë jeta. Saktësisht, ashtu siç ligjëron, me vështrime gjithnjë e më të gjera etike e estetike, e vërteta jetësore:

Ku ta kërkoj shpirtin e poetit?

(pyes unë)

shpirtin s'di gjë.

Po trupin ia pashë vjerrë

Çengelave të jetës

(më tha e vërteta).

(poezia "Ku ta takoj shpirtin e poetit")

Ndërsa karahas figurës aq konkrete e aq fluide të poezisë, shtegton nëpër këto hapësira tematike-motivore edhe figura e fëmijërisë, me gumshtin e saj poetik, me shqetësimet e moshës, vitesh të çekuilibruara të rritjes, për të arritur te përvoja apo te mësimi i saj i rëndë: "lufta e rrëzimit me ngritjen tek jeta". Po kur, vërtet, poeti dëshiron "të mos jetë poet"? Përmes një simetrie të bukur kontrastive të thënies e të formës poetike, Marinaj thur një poetikë të mahnitshme të Mitit mbi Frymëzimin. Është ai momenti, do të thoshim, i etheve solemne të frymëzimit, është ai çasti dramatik i një situatë, ku përplasen në laboratorinë e alkimisë krijuese diksioni, format, analogjitë konceptuale, idetë, simetritë e thënies, ritmet e ligjëritimit apo asimetria e mendimit:

Është ai momenti

Kur gjilpëra grafike e intervalit të kohës

Thyhet duke nxjerrë një klithmë abstrakte.

Kur madje edhe vetë koha sillet rreth poetit

Si e dalë nga ingranazhet

e tik-takut rrotullues të saj.

Poeti shkruan i rilënduar. Aq i ndërliqshëm e aq dramatik është ai çast, sa që ai do të dëshironte të mos jetë poet! Mirëpo, "lumturia e mundur" (një formulë tjetër lapidare mbi frymëzimin, mbi muzën), ia shpërblen me frytin e nxjerrë nga gjithësia me "kontrastin dehës".

Ndërsa ciklet tjera iu kushtohen imazheve të "çastit të përjetshëm", metafizik, si dhe imazheve jetësore në SHBA, Meksikë, Grenlandë (cikli "Infinit"); i kushtohen Kosovës, ku ka burime të ashpra e të forta tematike (cikli "Zero qetësi"); i kushtohen Shqipërisë në kalimin e saj të dhembshëm e dramatik të jetës së "tranzicionit"(cikli "Fytyrat e njerëzve

që dua").

Vjen në fund cikli me temën e rëndë sociale të përmasave planetare ("Bota nuk është tërësisht e bukur"). Nëpër këto meridiane planetare kulturash e universesh poetike, nëpër meridiane të përmasave të tilla në kërkim të të vërtetës, folësi lirik dëshiron ta shquajë, pra, të veçantën e tij, identitetin e tij njerëzor, etik, shpirtëror, e, mbi të gjitha, atë kombëtar. Nuk është e rastit, prandaj, pse Kosova është ajo dhembja jonë e përbashkët universale ekombëtare, kurse Shqipëria është ajo madhështia që e mban në këmbë. Së këndejmi, vjen ajo kërkesa këmbëngulëse e krijuesit për ta denoncuar kudo padrejtësinë dhe ashpërsinë enjë jete të rëndë; për ta mbitheksuar rebelizmin e fytyrën "tjetër" të rebelizmit: revoltën e poetikën e kontestimit.

EFEKTE TË KONTRASTEVE POETIKE



-- nga **Ilir Seci**, Korrik 2003

Lidhur me dy librat me poezi të Gjekë Marinaj, "Mos më ik larg" dhe "Infinit", botuar nga Shtëpia botuese "LSHA", 1995 dhe "Marinaj Publishing", 2000.



Poeti Gjekë Marinaj u bë i njohur në letrat shqipe, falë një poezie, e cila i dha famë të menjëherëshme saqë e detyroi të largohej nga vendlindja, nga frika e ndëshkimit, për shkak të konsekuencave që pasonin në Shqipërinë e asaj kohe. Bëhet fjalë për poezinë "Kuajt", të botuar në gazetën "Drita", në vitin 1990, e cila kishte nëntekste të theksuara kundër regjimit diktatorial. Që nga ajo ditë, poeti emigroi në Shtetet e Bashkuara, ku jeton edhe sot, duke ndjekur një model tjetër jetësor, por gjithësesi, ai mbetet një ndjekës

besnik i modeleve të një poezie moderne.

Botimi dhe suksesi i asaj poezie (sukses të cilin do ia kishin zili edhe poetët më të afirmuar), ishte edhe një detyrim dhe shtysë në kërkimin e mëtejshëm të pasionit poetik, duke dashtë të bindë secilin lexues, se "Kuajt" nuk ishte një poezi e rastit, apo "magnetizim" i përkohshëm poetik, i imponuar nga situata shabllone e atyre viteve.

Marinaj meton me këta dy libra të na thotë, se është ai poeti, i cili e ka tejkaluar poezinë e njohur në kërkimet e tij poetike, duke e arritë atë që çdo krijues ka synim, përsosjen e mjeteve shprehëse në artin e vet, mprehjen e tyre deri në elaborim të plotë - akt ky që është krejt individual, dhe që çdo krijues i mirëfilltë e realizon në mënyrën e vet. Në rastin e Marinajt, ne kemi të bëjmë me një poet të lindur, që kërkon me këmbëngulje të dalë nga niveli i krijimtarisë vargëzuese, bazuar në shqisën e lindur e të kultivuar dhe duke thelluar njohjet e tij mbi poezinë e botën në tërësi. Poeti e ka arritur këtë më në fund, dhe dy librat e tij e dëshmojnë këtë më së miri.

PERPUNIMI I TEMAVE

Poezitë e Gjekë Marinajt në të dy librat e tij, i qasen me sukses temës poetike dhe jo vetëm kaq; aty arrihet mishërimi i cilësive poetike, siç janë ato artikulative dhe semantike. Me të parën nënkuptohet aktualiteti i idesë me leksikun, strukturën e vargut. Me të dytën lidhet kuptimi i poezisë, sasia e ideve, masa e kuptimit, mesazhi dhe referencat. Këtu poeti arrin të përftojë një cilësi të re, pasi vlera e poezisë së tij nuk qëndron vetëm në tematikë, por pikërisht në mënyrën e trajtimit të temave. Poeti nuk zgjedh gjithmonë një temë të madhe, që të ketë sukses të lehtë, por ai prek çdo lloj teme, dhe falë cilësive të sipërpërmendura, ai arrin artin në këtë mënyrë:

*"Duroj gjithçka duhet duruar në këtë jetë;
dhëmbjet që ndjejnë nënat gjatë një lindje,
cicërimat ndjesëkërkuese të zogjve para të vegjëlvë,
të qarën e foshnjës nga shfaqja e dhëmbëve,
apo ngjeshjen e pluhurit pas fytirave të djersitura."*

Teksti poetik në poezitë e Marinajt shfaqet si shembull ku sintetizohen dy prirje: teksti si një përshkrim poetik i realitetit, i cili kalon nëpër një proces të atillë, ku faktet e përceptuara i nënshtrohen pranimit të poetit, seleksionimit subjektiv dhe riprodhimit si art, që nuk i largohet krijimit të një logosi, i cili që në fillim përkon me modelin poetik, ku gërshetohen semantizimi i titullit me semantizimin e figurës, semantizimi i ritmit me harmoninë e formës aludive të idesë, dhe ideja konkrete në anën tjetër. Pra, si rrjedhojë e tipit të parë të prosedeut poetik, është stili përshkrues e egzak, sa i përket strukturimit të temës poetike. Poezitë e tipit tjetër shquhen me kohezionin e planit semantiko-figurativ, me reduktim të sintaksës, që ka si rezultat mundësinë e transformimit sa më të dendur, apo preokupimit në njësi sa më të pakta leksikore. Kur bëjmë fjalë për poezinë e stilit kolokvial, teksti i tillë, të folurit poetik, i afrohet më shumë burimeve të së folmes së përditshme, duke eliminuar në këtë mënyrë mbingarkesën e shprehjes, me ç'rast arrin të thjeshtojë ndjeshëm komunikimin me lexuesin:

*"Ç'mu dhimbs sot mëngjesi
paska djersirë vesë
nga mundimi për të lindur
Diellin e madh..."*

EFEKTET E KONTRASTEVE

Poezitë e Marinajt dallojnë në dy karakteristika dominuese: substancialiteti i imagjinatës poetike dhe referencialiteti që lidhet me dukuri konkrete, shpesh edhe nga rrafshi jetësor me burimësi sociale. Këtë koncept mund ta shohim edhe nga titulli, i cili në të dy rastet i përgjigjet përmbajtjes, por edhe shpreh konceptin kryesor, që ndjek autori në sajimin e poezisë. Cilat janë atëherë efektet e imagjinatës substanciale të poetit? Poezia e Marinajt dallohet për trajtimin e disa preokupimeve obsesive, ndër të cilat është edhe vendlindja, dhe ambienti ekzistencial i njeriut në tërësi. Këto tipare i ndeshim në të dy librat.

"Libri si peshqesh nga prindërit" është një titull nga libri i parë "Mos më ik larg", ndërsa poeti evokon kujtime nga jeta e vet në vendlindje. Kurse një shembull i daljes në paradigma ekzistenciale është poezia tjetër e librit të dytë "Infiniti", "Afro-amerikanët":

*"E sotmja e zeshkaneve sillet si pështymë në ajër
mbi fytirat tona
dhe s'di mbi cilën të bie"*

Këtu shihet, se substancialiteti i imagjinatës poetike shfaqet nga materia, elementarizmi natyror, format themelore të saj, dramat dhe konfliktet bazë të botës në tërësi, të cilat poeti i përgjithëson, duke i marrë edhe mbi vete, si pjesëtar i këtij planeti. Me shtysa të tilla, poeti e fut imagjinatën e përgjegjeshme në veprim, ku një përgjegjësi e tillë shfaqet edhe tek poezia tjetër "Vajza arabe", duke e paraqitë kështu edhe përgjegjësinë e poetit mbi botën.

Prirja nga substancialiteti, nga natyra e gjërave, nga elementariteti i jetës, bën që poezia të manifestohet si një induksion e deduksion, e jo thjeshtë si veprim i logjikës abstrakte, me shumë si imazhe, si peisazhe që i ngjyros vetë poeti. Poeti ka ndërruar ambient, nga vendlindja është zhvendosur në një tjetër skaj të globit, dhe aty ai nis e shpalos

individualitetin e tij, problemin e lidhjes me një ambient tjetër, që e bart kuptimin e identitetit të tij shpirtëror, madje edhe social e nacional. Pikërisht, kalimet e tilla nga një mjedis në tjetrin, Marinaj i konfiguron edhe në artin e vet, kur bën kalimin nga ambienti në qenie. Pra, kufiri i diferencimit të vetëdijes nga forma elementare, është zona më e preferuar tematike, është problemi qenësor, që aktualizohet posaçërisht, kur dihet se nuk kemi të bëjmë me një ndëthurje të raporteve njeri-univers, duke mos veçuar këta nga njëri-tjetri:

*"Toka sillet e hutuar viseve të poetit
shpreson, mbahet që të mos bjerë...*

Bri tij

*ajo lumnon më shumë se zeroja pas njëshit,
ndjehet më e sigurtë se jeta pranë vdekjes."*

Shihet pra që poezia e këtij poeti është sublimacion i emocioneve dhe fiksion i gjendjeve e fenomeneve të botës në tërësi. Thellësia e mendimit, ideja e fshehur nën leksikon e shtruar, nganjëherë edhe të zakonshëm, janë tipare dalluese të cilat padyshim, janë rezultat i imagjinatës substanciale të poetit. Dallohet një konstante në krijimtarinë e Marinajt, poeti është më shumë pasues i linjës së F. Sosyr, për një "ekonomizim të shprehjes", që e bën një poezi përherë e më të përsosur, dhe nga libri i parë në të dytin, ne dallojmë shtimin e kësaj cilësie, gjë që gjendet pak ndër krijimet e sotme, pasi kjo kërkon njohje e thellim të mëtejshme të njohurive në këtë fushë. Preokupimet me bazë origjinën, ato që lidhen me diçka, që për poetin ka një peshë të jashtëzakonshme, janë privilegj i pak poetëve.

Temat që i paraqet poeti në fjalë, janë të arrira, sepse ai shkruan pa u sforcuar në kërkimet e temave, "gjuetinë e temave" siç mund të thuhet, me të drejtë. Forma dhe mënyra se si i realizon këto preokupime në poezitë e tij Gjekë Marinaj, stili se si i ka funksionalizuar ato cilësi në brendinë poetike, na bën të kuptojmë, se ky poet jo vetëm që ka arritur të mëvetësojë botën e vet poetike, porse ai mundet t'ia imponojë këtë botë me mjaft lehtësi e mjeshtëri, lexuesve të tij. Kjo, falë artit të talentuar poetik.

